

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/12/22
Datë: 21.11.2022 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e ndymbedhjetë - (2022) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: **Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;**
Data: 30.11.2022, ora 10⁰⁰.




Rendi i ditës:

1. Dhënja e betimit të antarit të ri të asamblesë komunale në Komunen e Junikut z. Mursel Salihaj nga radhet e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Statutit të Qendres kryesore të mjekësisë familjare në Junik;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotesim – ndryshimeve të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunes me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në teritorin e Komunes së Junikut;
5. Shqyrtimi dhe Miratimi i kërkesës për Pronart e paluajtshme të Komunës të planifikuara për dhenjen në shfrytezim;
6. Të ndryshme;



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-11/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.10.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së njëmbëdhjetë (11) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.10.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj.Gentiana Tofaj-DZHE, z.Zenun Shala-DUKM, z.Xhavit Velijaj, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganiyaj-DSHPMS.

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. **Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK-ka munguar**
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, meqë është drejtoresha e administratës prezent unë kam një pyetje, fshatrat Jasiq dhe Gjocaj a administrohen nga komuna e Junikut dhe qytetarët e këtyre dy fshatrave a paguajn taksa ne Komunën e Junikut, tatimin ne pronë dhe taksat tjera?

znj.Leunora Shehu, përshëndetje për të gjithë, taksa e tatimit ne pronë nuk përfshihet te drejtoria e administratës

z.Shpejtim Gacaferi, z.Lulzim Gacaferi, jemi te pika e rendit te ditës.

z.Lulzim Gacaferi, unë nuk levizi nga kjo kërkesë, qytetarët e këtyre dy zonave a paguajnë taksa ne Komunën e Junikut? Andaj dua pergjigje nga kryetari i Komunës drejtorët, mos me injoroni Kryesues.

z.Shpejtim Gacaferi, nuk mundeni te merrni pergjigje pa kaluar rendi i ditës.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për te gjithë, unë po i kuptoj z.Zenel Malokun, e z.Leonard Lllollunin, edhe po e di edhe qëllimin e tyre, si gjest çdo kush që ka ndëgjjar askujt mirë nuk i ka ardhur dhe e kan dënuar dhe nuk di se çka kemi ne te diskutojmë këtu në kuvend ku rasti është ne polici dhe prokuri, andaj ne si LDK e perkrahim këtë rend te ditës te propozuar.

z.Leonard Lllolluni, unë propozoj që si pikë e rendit te ditës te hynë edhe diskutimi për shkatrrimin e varrezave ne fshatin Gjocaj.

z.Shpejtim Gacaferi, ateher fillimisht votojmë për propozimin tim që patëm rendin e ditës me pikën shtesë te kërkeses se drejtorisë se Shëndetësisë, pastaj e qesim në votim edhe kërkesën e grupit te AAK-se, kush është për rendin e ditës te propozuar me pikë shtesë kërkesën e Drejtorisë se Shëndetësisë? për 8 vota, kundër 6, abstenim 0 vota, tani e qes ne votim edhe kërkesën e grupit te AAK-se, kush është për? 10 vota për, kunder 4 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se u miratua rendi i dites me këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Raporti periodik i buxhetit për periudhen Janar-Shtator 2022 i Komunës së Junikut,
3. Formimi i komisionit për plotësim-ndryshim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për hartimin e rregullores për Institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Junikut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e një antari të KKSB_së,
6. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të kuvendit rreth mirëmbajtjes dhe kujdesit të deponisë së materialeve inerte në Komunën e Junikut,
7. Kërkesë për Draft Statutin e QKMF_së "Dr.Ali Hoxha"-Junik,
8. Diskutimi për shkatrrimin e Varrezave ne fshatin Gjocaj.
9. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,

me rastin e manifestimit të 110 vjetorit të "Kuvendit të Junikut" 715€ si dhe furnizimin me billboarda po ashtu me rastin e 110 vjetorit të "Kuvendi i Junikut" 970€, në total janë 92696€.

znj. Leonora Shehu, sa i përket shpenzimeve të telefonisë nga Administrata gjithsejtë është 1952€, në të kemi pranuar një faturë nga telefonia Vala e që është nga zyra e Kryetarit dhe në mungesë të mjeteve nga zyra e Kryetarit pagesa e kësaj fature është bërë nga Administrata.

z. Lulzim Gacaferi, po më intereson a keni bërë kontratë të re me operatorët e telefonisë.

znj. Leonora Shehu, jo nuk ka kontratë të re sepse kemi një kontratë që është valide deri në fund të këtij viti 2023.

znj. Vjollca Qestaj, u pa se ka shqetsim të madh për shpenzimet në kategorinë në mallra dhe shërbime, unë folë në për një vit fiskal, dhe buxheti ndahet për një vit fiskal dhe ai buxhet duhet të shpenzohet për atë vit fiskal por ajo çka ka ndodhur në këtë vit 2022 është se në më shumë se 105000€ borxhe të vitit 2021 kemi paguar në vitin 2022 e ato borxhe përfshihen borxhet e derivateve, për telefoninë mobile.

znj. Gentiana Tofaj, përshendetje për të gjithë, u përmenden disa shpenzime nga zhvillimi ekonomik në shumë prej 980€ është e vertetë që nuk është borxh i viti të kaluar, mirëpo në kemi patur një manifestim "Ditët e Gjeravices" dhe me këtë shumë është paguar drekë.

z. Demokrat Ganiqaj, përshendetje për të gjithë, kur jam emëruar drejtor me kan ardhur dy fatura për Gusht dhe Shtator të vitit 2021 njëra është në shumë prej 1300€ dhe tjetra është në shumë prej 1500€, janë afër 3000€ borxhe për derivate nga viti 2021, por pavarësisht kësaj në kuadër të drejtorisë janë automjeti i Inspektorëve, kamionat e Zjarrfikësve, traktori dhe është bageri që e kemi si donacion nga bashkvendasi donacion për rrafshimin e mbeturinave, dhe për këto arsyeje neve si Shërbime publike na bëjnë shpenzues me të mëdhenjë të derivateve në Komunën e Junikut.

z. Leonard Llojlluni, për drejtorin e shërbimeve Publike kam një pyetje, a është shë ky borxh në shumë prej 294€ për udhetime jashtë vendit, sepse nëse flitet në total siç po flitet këtu atëherë del se edhe kjo shumë është borxh, andaj mos folni në total, sepse ka më shumë shpenzime të këtij viti se borxhe të viti të kaluar.

z. Xhemë Tofaj, përshendetje për të gjithë, unë desha të pyes Drejtoreshën e e Zhvillimit Ekonomik, kjo për manifestimin e "Ditët e Gjeravices" në shumën prej 980€ pse është quajtur drekë zyrtare?

znj. Gentiana Tofaj, në momentin që ka një marrëveshje në mes Komunës dhe organizatorëve shoqatës "Rrasa e Zogut" konsiderohet si kod ekonomik që në mundemi me bërë pagesën, pra është kod ekonomik kategoria drekë zyrtare.

3. Formimi i komisionit për plotësim-ndryshim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2023,

z.Sadri Krasniqi, grupi i LDK_se propozon z.Alfred Gaxherri.

z.Xhavit Velijaj, komisioni mund te perbehet nga tre, pesë apo shtatë antar, por çështja është që në perberjet të ketë anëtar qe kane njohuri ne aspektin profesional, grupi fillimisht e punon si draft dhe me pas e kalon edhe dy here nëpër kuvend ky dokument për miratim.

z.Lulzim Gacaferi, ku ka këtu profesionalizëm, unë propozoj qe ekzekutivi ti ketë dy anëtar, kuvendi tre antar dhe ne e votojmë.

z.Besart Tofaj, pershendetje per te gjithë, unë kërkoj që të bëhet një lëshim në ketë pikë që kuvendi ti dërgoj tre anëtar.

z.Zenel Maloku, unë e di se kuvendi është organ me i lartë se ekzekutivi, kuvendi jemi ne dhe ne jemi perfaqësues të qytetarëve, te gjitha votat e Komunës se Junikut i ke këtu, andaj propozimi i tyre eshte i drejtë, që kuvendi ti dërgoj tre anëtar ne ketë komision.

z.Xhavit Velijaj, numrin e përberjes se komisionit e percakton rregullorja e kuvendit dhe ky draft ka me kaluar nëpërmjet KPF_se dhe kuvendit andaj nuk ka këtu kurrfarë tejkalimi te kuvendit.

z.Lulzim Gacaferi, Drejtor i nderum unë po di se kalon nëpër Kuvend por çështja është të mos transparenca dhe injorimi i LVV_je ketë nuk e lejoj.

znj.Rajmonda Krasniqi, ne KPF e kemi diskutuar vetëm si çelës, propozimi i anëtarëve është mbetur të bëhet në kuvend.

z.Leonard Llojuni, kryesues qite ne votim si çelës a jemi per dy anëtar apo për tre anëtar?

z.Sadri Krasniqi, une propozoj qe numri i anëtarëve te rriten në shtatë.

z.Zenel Maloku, unë propozoj qe komisioni te jetë në përbërje prej tre anëtarëve nga Kuvendi.

z.Shpejtim Gacaferi, e qes ne votim qe komisioni te jetë në përbërje prej tre anëtarëve të kuvendit kush eshte për? për 13 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, tani i pres propozimet nga ana e juve, LDK propozon z.Alfred Gaxherri, AAK propozon znj.Rajmonda Krasniqi, LVV propozon znj.Eliza Pepshi, unë propozoj qe nga ekzekutivi te hiqet propozimi i tretë që është z.turim Ganija dhe komisioni te përbehet nga z.Xhavit Velijaj Kryesues, z.arton Krasniqi anëtar, z.Alfred Gaxherri anëtar, znj.Rajmonda Krasniqi anëtare dhe znj.Eliza Pepshi anëtare,e qes në votim, ne sallë jan prezent gjithjes 13 antar te kuvendit, kush është për ketë përbërje? 13 vota për kundër 0, abstenim 0 vota, konstatoi se komisioni u miratua.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e një antari të KKSB_së,

Sqarimin dhe arsyetimin e beri nënkryetari i Komunës se Junikut z.Besart Tofaj.

z.Demokrat Ganiqaj, e para komuna nuk e ka lejuar ketë as ne si drejtori dhe nuk kemi pasur as kerkese per lejin e kesaj, dhe me e tregu ne detaje ketë ngjarje, ka qen drek dhe kemi pare disa kamijona qe jane duke qar dhe ne deponi, e kam thirrur inspektorin dhe jemi shkuar me qellim per te mos lejuar qe ta qet ne deponi dhe kur jemi shkuar kemi par se është ka qesin dhe dhe materiali syngjer, e kemi urdhëruar qe ti largoje ato materiale dhe ja kemi ndaluar ti hudhe ne deponi, mire por ata na kan then se neve na ka ftuar pronari i tokës, ne i kemi thënë se pronën private mundesh me mushur me dhe por jo me ketë material dhe e kemi detyruar qe ti largoje syngjeart dhe ne prezencen tone i ka larguar, po se kush ja ka vure flaken ne nuk e dimë, dhe meqe zjarrfikësit e ka mare informatën ka shkuar qe ta fikin zjarrin atëherë kanë pasur pengesa nga pronari i tokes, dhe me kete as demokrati si individ po as komuna nuk kanë pasur te bëjnë asgjë me kete qeshtje, perkundrazi i ka ndalu dhe i ka shti me i largu ato materiale.

z.Lulzim Gacaferi, sa letar ndeshkuese keni bere ju si Komune ndaje kompanisë ne fjale, dhe si eshte e mundur qe ti personalisht t'ju thuani inspektoreve se unë e mare ketë përsipër, ju duhet te keni kujdes me mua sepse une ju padis, i padis edhe ata qe kanë vënë zjarrin, edhe zjarrfikësit edhe policine, ju keni sjelle me dhjetar mija tona ne komune tone material kanceriogjen, ti ju ke thane inspektorave, zjarrfiksave se ti e mere persiper kete.

z.Xhemë Tofja, kam një pyetje për nënkryetarin, ne kemi kërkuar një raport nga zjarrfikësit dhe nga policia dhe nuk na ka sjelle kërkesën e kemi bere ne mbledhjen e KPF_se dhe nuk na keni sjelle.

z.Shpejtim Gacaferi, kuvendi nuk ka te drejte te kërkojë raport nga policia, kuvendi nuk ka te drejte te kërkojë raport nga zjarrfikësit sepse ata i raportojne AME_se

z.Leonard Lolluni, drejtor nuk mu pergjigje ne pytje a keni iniciuar rastin ne Polici.

z.Demokrat Ganiqaj, per deri sa ato i ka larguar ne nuk kemi inicuar rast ne polici.

z.Xhemë Tofaj, drejtori z.Zenun Shala me ka thënë se ne prezencën tone i ka shkarkuar dy kamijona dhe kan vazhduar te nesmren po me te njëjtin avaz pa ndaluar ketë e ka thënë ne mbledhjen e KPF_se, kjo eshte edhe ne procesverbal dhe mund te jua sjelli.

z.Zenun Shala, përshëndetje te gjithëve, kryetari komune te dielën me te par tymin me ka marr mua dhe kemi shkuar te shikojmë se ku është duke djegur zjarri dhe kur kemi shkuar kanë qenë dy kamijona te zbrasur, deri sa ne ishim duke zbritur nga makina ata kanë ikur, zjarri ka qen shume i madhe dhe menjeher i kemi thirrur zjarrfiksat, dhe kan ardhur, zjarrfikësit e kanë evituar zjarrin na mali qe mos te zgjerohet, dhe per fat te mire ate nate ka ra shi dhe zjarri është shuar, te nesemren ne mengjes kemi shkuar se a eshte shuar zjarri, dhe kur kam shkuar atu kanë ardhur edhe dy kamijona tjer dhe nuk i kam lene te shprazen kjo është kështu dhe kështu kam thënë edhe ne mbledhjen e KPF_se.

z.Zenel Maloku, drejtori z.Ganiqaj po bie ndesh me fjalën e vet sepse ne fillim tha se i kanë shti qe ti largojnë ata syngjerë e me pas është ndezur zjarri atëherë kujt ja kanë vu zjarri nëse nuk

z.Shpejtim Gacaferi, meqë nuk ka kërkesë tjetër e qes ne votim ne salle prezent janë 13 anëtar te kuvendit, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se draft statuti për QKMF_ne leximin i pare u miratua.

8. Diskutimi për shkatërrimin e Varrezave ne fshatin Gjocaj.

z.Leonard Lolluni, kjo çështje është ngritur si shqetësim para një muaj para se te publikohet ne mediaj, ka qene asamblisti z.Zenel Maloku i cili ka pyetur drejtorin e shërbimeve publike se ato varre a janë ka largohen nga ana e Komunës apo ne mënyrë private, dhe si përgjigje ka mare nga drejtori se ajo çështje s`ka te beje me Komune, me pastaj kam dëgjuar ne media se janë dëmtuar varrezat ne fshatin Gjocaj, dhe unë ju beje pyetje Drejtorisë për Shërbime publike, inspektorëve ku një pronë publike komunale dëmtohet a keni marr masa ndëshkuese për dëmtuesit e pronave komunale ne këtë rast te varrezave.

z.Demokrat Ganiqaj, sot po i vendoset kapaku kësaj Çështje sepse krejt kjo është çështje politike, ajo pjesë menaxhohet nga parku nacional dhe inspektimi i asaj pjese nga inspektorat komunal është e ndaluar, nuk ka as uzurpim as kurrigje tjetër.

z.Leonard Lolluni, unë kam qene edhe vet Drejtor, dhe kur ka ardhur çështja për nderimin e staneve ne bjeshkë dhe shume çështje tjera prokuroria ka kërkuar fillimisht dokumente nga ne si Komune a kemi ndërmarrë veprime, dhe fshati Gjocaj është pjese e Komunës se Junikut, nuk është prone e parkut nacional, parku nacional menaxhon vetëm me pyjet, me ruajtjen e mjedisit.

z.Zenel Maloku, unë këtë çështje e kam thënë edhe me parë, ka qytetar si Sahit Rama qe me ka thënë se e ka thirr drejtori z.Demokrat Ganiqaj e i ka thënë se duhet me i larguar varret sepse duam ta zgjerojmë rrugën, dhe ky qytetar është detyruar qe ti langoje dy varret dhe i ka kushtuar 1400€ me i ç 'varrosë. Mu si përfaqësues i fshatit Gjocaj me kane thirrur nga Peja tre persona dhe me kane pyetur se a jam ne dijeni se drejtori i ka rrafshuar varret, unë nuk kam qene ne dijeni, te nesërmen kane ardhur dhe njeri nga ta ka inicuar rastin ne Polici dhe ka kërkuar nga Policia te vinë ne vend te ngjarjes dhe mbasi jemi shkuar ne vend te ngjarjes kemi takuar drejtorin, babin e drejtorit. Dhe me se shumti jam i inatosur ne Polici sepse kur shkuam atje than se kjo paska përfunduar dhe sjellja e tyre si te ishte asgjë. Qytetaret janë te zhgënjyer me këtë gjest dhe sipas prokurorisë kjo është një vepër penale, ndërsa ne baze te fes hoxha thotë personit qe ja prish varrin është si te prishesh një shtëpi të nje personi te gjallë , por nëse ja thenë eshtrat dhe ja humbe është si me e vra një te gjallë, dhe e tera kjo si te mos ishte asgjë, unë po ta kisha pushtetin e KFOR_it apo NATO_s një varr nuk do ta kisha dëmtuar, por si duket se Drejtori ka dhenë edhe para për ti dëmtuar këto varre për mua kjo është tmerr.

z.Dervish Bajraktari, mua me vjen keq nga drejtori qe po ju ike përgjegjësi kur mundohet ta paraqes si parqe nacional varrezat e fshatit "Gjocaj", atëherë pse interesohesh mbasi qe fshatrat "Gjocaj" dhe "Jasiqi" janë park nacional pse ju bene thirrje qe te mos hedhin mbeturina aty ku këta qytetarë janë ne prona te vete e qe sipas juve nuk është përgjegjësi e komunës se Junikut, andaj Drejtor mos ju ik përgjegjësi.

z.Lulzim Gacaferi, u diskutuar edhe nga koleget këtu, Drejtor ju po thoni se atë pjesë e menaxhon parku nacional, ne rregull, por parku nacional nuk i menaxhon popullatën, popullatën e menaxhon komuna e Junikut, banorët e asaj pjese paguajnë tatim këtu ne komunën tone. Si

z.Fatos Shala, unë isha ne QKMF dhe pyeta pikërisht për këta dyshek dhe krevate, me kanë thënë se kane dyshek dhe krevate rezervë dhe do ti zëvendësojnë ti gjitha ata dyshek dhe krevate qe janë te dëmtuara.

z.Besart Tofaj, unë e kam garancinë nga ministri qe do ta sigurojmë ujin për lagjen “Agim Ramadani” ministria do te na ndihmojë sidomos për ujin e pijes.

z.Shpejtim Gacaferi, nënkryetari nuk bon plane bën ekzekutivi, e sa i përket zërimit unë nga dita e parë jam i interesuar qe ta kemi, por kjo shkon nëpërmjet tenderimit.

znj.Ermelinda Lolluni, përshëndetje për te gjithë, kam një pyetje për ty kryesues, a kanë te drejtë asamblastët te lëshojnë sallën e kuvendit pa përfunduar pikat e rendi i ditës sepse mua me duket e pa logjikshëm.

z.Shpejtim Gacaferi, e mirë nuk është po as masë ndëshkuese nuk ka.

z.Leonard Lolluni, unë pata një çështje qe ndodhi me herët, do ishte mirë qe ta kemi zërimin dhe munden me u dëgjuar vetëm ne asamblastët dhe jo këta qe po vijën e qe nuk janë pjesë e Kuvendit dhe ne nuk e dimë se çfarë funksionesh kanë dhe po marrin fjalën pa ju dhanë ju, plus ka po dalin këtu te dera po na fyejnë.

z.Zenel Maloku, lagjja “Agim Ramadani” e ka ujin katastrof nuk është uji i pijshëm dhe do ishte mirë qe komuna te le diçka qe është me pak e nevojshëm dhe te bini ujit ne lagjen “Agim Ramadani”.

z.Lulzim Gacaferi, pyetje për drejtorin e shëndetësisë kur do te betë qe QKMF_ja te funksionoj 24h dhe aparati i rëntgenit kur do te jete funksional dhe ne shërbim te qytetarëve te komunës tonë, dhe pyetje për Drejtorin e arsimit a keni siguruar lëndën djegëse për dimër.

z.Fatos Shala, me afate është problem te flitet por ne kemi mare premtime nga ministria se do te na mbështesin me staf shtesë dhe ne baze te dhënave qe te funksionojmë 24h na nevojiten edhe katër infermier dhe dy shofer qe te funksionojmë si duhet dhe nëse zgjidhen këto problem ne qe nesër do ja nisim te funksionojmë 24h.

z.Xhavit Velijaj, po e kemi siguruar.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli te mbyllur mbledhjen e tetorit 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

STATUTI

I

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

STATUTE

of the

MAIN FAMILY MEDICINE CENTER

STATUT

GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE

1.QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik (në tekstin e mëtejme: KPSH). 2.Themelues i QKMF-së është Kuvendi Komunal i Komunës së Junikut. 3.QKMF-ja në Junik ka filluar punën në vitin 2007.	1.The MFMC has the status of a public legal entity, having the quality of the employing authority, where the Public Primary Healthcare is organized, provided and implemented (hereinafter: PHC). 2.The founder of the MFMC is the Municipal Assembly of the Municipality of Junik. 3.The MFMC in Junik has started the work in the year 2007.	1.GCPM ima status javnog pravnog lica, u svojstvu autoriteta poslodavca, gde se organizuje, pruža i primenjuje Javna Primarna zdravstvena nega (u daljnjem tekstu: PZN). 2.Osnivač GCPM-e je Skupština Opštine Junika. 3.GCPM-e u Juniku je počeo sa radom u 2007 godine.
II - Emërtimi dhe Selia Neni 3 Emërtimi 1.Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Junik. 2.Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës dhe aprovohet nga Kuvendi Komunal, në bazë të procedurave ligjore. 3.Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSH.	Article 3 Designation 1. The name of the institution is: Main Family Medicine Center in Junik. 2.The recognition mark of this institution is unique for all MFMC in the Republic of Kosovo and is approved by the Municipal Assembly, on the basis of legal procedures. 3.The name of MFMC, FMC and FMA should be clearly indicated at the entrance of the respective health institution of PHC.	II – Naziv i Sedište Član 3 Naziv 1.Naziv institucije je: Glavni Centar Porodične Medicine u Juniku. 2.Identifikacioni znak ove ustanove je jedinstven za sve GCPM u Republici Kosovo i usvaja se od Skupštine opštine, na osnovu pravnih procedura. 3.Naziv GCPM-a, CPM-a i APM-a mora biti jasno nadpisan na ulazu dotične zdravstvene ustanove PZN-a.

Status GCPM

4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë. 5. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori. 6. Çdo vulë ka numër identifikues.	4. The stamp must contain the designation of the institution and according to this Statute must be in the languages, which are in official use in Kosovo. 5. The number of stamps, the manner of using the stamp and authorizing of persons for using and preserving the stamp shall be decided by the director. 6. Each stamp has an identification number.	4. Pečat treba da sadrži naziv institucije, prema ovom Statutu, i da bude na jezicima koji su u službenoj upotrebi na Kosovu. 5. O broju pečata, načinu korišćenja i o ovlašćenom licu za korišćenje i čuvanje odlučuje direktor. 6. Svaki pečat ima identifikacioni broj.
III-Veprimtaria, Shërbimet dhe Përfaqësimi i QKMF Neni 6 Veprimtaria 1. Veprimtaria e QKMF përfshinë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në KPSh për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës. 2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Junikut t'u ofrojnë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si	III-Activity, Services and Representation of MFMC Article 6 Activity 1. The activity of MFMC includes the provision of health services in PHC for the population of the municipality, as an activity of special interest, through the implementation of the concept of family medicine, within the unique health system of Kosovo. 2. The concept of family medicine consists in provision of comprehensive, efficient health services to all residents of the Municipality of Junik and in continuation to individuals and families at all stages of life, on the basis of scientific data, through the family doctor as	III-Delatnost, usluge i zastupanje GCPM Član 6 Delatnost 1. Delatnost GCPM-a obuhvata pružanje primarnih zdravstvenih usluga u PZN-u za stanovništvo opštine, kao delatnost od posebnog interesa, kroz primenu koncepta porodične medicine, u okviru jedinstvenog zdravstvenog sistema Kosova. 2. Koncept porodične medicine se sastoji u tome da se svim stanovnicima Opštine Junika pružaju sveobuhvatne i efikasne zdravstvene usluge, u kontinuitetu, pojedincu i porodici u svim životnim etapama, na osnovu naučnih podataka, kroz određivanje porodičnog lekara.

5.6. Specialist i Biokimisë klinike; 5.7.1 infermier i/e diplomuar; 5.8. Mami e diplomuar; 5.9. Teknik laborant; 5.10. Teknik i farmacistë; 5.11. Teknik/asistent i stomatologjisë; 5.12. Radiologu dhe tekniku i radiologjisë nëse funksionalizohet kabineti i Rtg; 5.13. Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë; 5.14. Bashkëpunëtorët profesional me shkolim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve sipas Ligjit të Shëndetësisë. 6. Specialistët nga lëmitë e tjera, mund të vazhdojnë punën në KPSh si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim. 7. Konsulentët në KPSh sipas paragrafit 3 të këtij Neni ofrojnë shërbime konsultative në QKMF.	5.6. Specialist in Clinical Biochemistry; 5.7. Graduated nurse; 5.8. Graduated midwife; 5.9. Laboratory technician; 5.10. Pharmacy technician; 5.11. Dentistry technician / assistant 5.12. Radiologist and radiology technician in the institutions where the Rtg cabinet is operational; 5.13. Medical professionals with a middle or high education, as defined in the official register of the Ministry of Health; 5.14. Other professional associates with non-medical education, registered in the official register by the decision of the Minister of Health, at the proposal of the respective Chamber of Health Professionals according to the Law on Health. 6. Specialists of other fields can continue working in the PHC as a family doctor consultant until retirement. 7. According to paragraph 3 of this Article, consultants in PHC provide consulting services in the MFMC and FMC.	5.6. Specijalista klinike biokemije, 5.7. Diplomirani/a medicinska sestra; 5.8. Diplomirana akušerka; 5.9. Laboratorijski tehničar; 5.10. Farmaceutski tehničar, 5.11. Tehničar/asistent stomatologije, 5.12. Radiolog i radiološki tehničar u ustanovi ako funkcioniše Rtg kabinet; 5.13. Ostali zdravstveni stručnjaci sa srednjim i visokim kvalifikacijama, određenim u službenom registru Ministarstva; 5.14. Stručni saradnici sa školovanjem van oblasti zdravstva, evidentirani u službenom registru odlukom Ministarstva zdravstva, na osnovu predloga dotične Komore stručnjaka po Zakonu o zdravstvu. 6. Specijalisti iz ostalih oblasti mogu da nastave rad u PZN-u kao konsultanti porodičnih lekara do penzionisanja. 7. Konsultant u PZN-u po stavki 3. ovog člana pružaju konsultativne usluge u GCPM-u i CPM-u.
--	--	---

1.11. Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale. Neni 8 Përfaqësimi 1.QKMF në Junik është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor publik në Republikën e Kosovës. 2.QKMF kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi. 3.Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, fjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi. 4.Drejtori i QKMF ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF me pëlqim të Drejtoratit Komunal për Shëndetësi dhe Mbrojtje Sociale.	1.11. Distribution of medicaments from the essential list. Article 8 Representation 1.MFMC in Junik is an institution, which is part of the network of public Primary Healthcare institutions in the Republic of Kosovo. 2.MFMC carries out and provides primary healthcare services for the citizens of the municipality, pursuant to the legal provisions in force. 3.For the signing of contracts, whereby are acquired, alienated or sold MFMC capital buildings and equipment, with or without regeneration value, first there is required a proposal by the management of the MFMC and the approval by the founder, based on the laws in force. 4.The Director of MFMC has all the authorizations for legal and business representation, within the activity of MFMC upon the consent of the Municipal Directorate of Health and Social Welfare.	1.11. Raspodela lekova sa esencijalne liste. Član 8 Zastupanje 1.GCPM u Juniku je institucija, koja je deo mreže javnih institucija Primarne zdravstvene nege, u Republici Kosova. 2.GCPM obavlja i pruža usluge primarne nege za građane opštine, prema zakonskim odredbama na snazi. 3.Za potpisivanje ugovora, kojima se stiču, otuđuju ili prodaju objekti i kapitalna oprema, sa ili bez regenerativne vrednosti GCPM-a potreban je prvo predlog rukovodstva GCPM-a i saglasnost osnivača, na osnovu zakona na snazi. 4.Direktor GCPM ima sva ovlašćenja za pravno i poslovno zastupanje, unutar delatnosti GCPM uz saglasnost Opštinske Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
---	--	---

1.2.5. Njësia ose Zyra për shërbime teknike.		1.2.5. Jedinica ili Kancelarija za tehničke usluge.
1.3. Barnatorja Qendrore:	1.3. Central Pharmacy:	1.3. Centralna Apoteka:
1.3.1. Barnatorja qendrore është njësi organizative e QKMF e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike; 1.3.2. Në QMF / AMF funksionojnë barnatoret doracake të cilat menaxhohen, furnizohen dhe monitorohen nga barnatorja Qendrore në QKMF;	1.3.1. The central pharmacy is an organizational unit of MFMC which is established and operates according to the laws and sub-legal acts that regulate the pharmaceutical activity; 1.3.2. Within FMC /FMA operate manual pharmacies which are managed, supplied and monitored by the central pharmacy in MFMC;	1.3.1. Centralna apoteka je organizaciona jedinica GCPM-a koja se osniva i funkcionise prema zakonima i podzakonskim aktima koji uređuju farmaceutsku delatnost; 1.3.2. U CPM-u / AMF-u rade priručne apoteke koje se rukovode, snabdevaju i nadgledaju od centralne apoteke u GCPM-u;
1.3.3. Nga barnatorja qendrore dhe njësive e saja ne QMF/AMF shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkuara në recetat unike nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare; 1.3.4. Me barnatoren qendore udhëheq Shefi i Barnatores.	1.3.3. The central pharmacy and its units in FMC /FMA distribute only the drugs from the Essential List of Medicines, allowed by the Ministry, and prescribed in unique prescriptions, by the Doctors of the Family Medicine Sector; 1.3.4. The central pharmacy is managed by the Chief Pharmacist.	1.3.3. Iz centralne apoteke i njenih jedinica pri CPM-u/APM-u mogu da se raspodele samo lekovi sa Esencijalne liste lekova, dozvoljene od Ministarstva, i propisanih u jedinstvenim receptima, od lekara Sektora Porodične Medicine; 1.3.4. Centralnom apoteku vodi šef apoteke.
2. Qendra e Kryesore e Mjekësisë Familjare në Junik është institucioni i vetem i KPSH në Komunën e Juniku (nuk ka QMF dhe AMF).	2. The Main Center of Family Medicine in Junik is the only PHC institution in the Municipality of Junik (there is no FMC and FMA).	2. Glavni Centar Porodične Medicine u Juniku je jedina ustanova institucija IZS-a u Opštini Junika (ne postoji CPM-a i APF-u).
3. Rrjeti i Institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 5, i nenit 6 do të jetë objekt i revizimit periodik që do të ndërmerret nga	3. The network of health institutions according to paragraph 5, of article 6 will be subject to periodic revision that will be undertaken by	3. Mreža zdravstvenih ustanova prema stavu 5, člana 6 će biti predmet periodične revizije koju

V-Udhëheqja dhe trupat e QKMF	V-MFMC administration and bodies	V-Upravljanje i tela GCPM-a
Neni 11 Këshilli Drejtues, Struktura 1.Këshilli Drejtues ka 7 anëtarë: 1.1.Drejtori i QKMF, i cili e kryeson Këshillin; 1.2.Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare; 1.3.Kryeinfermier/ja i/e QKMF; 1.4.Udhëheqësi i Departamentit të Administratës; 1.5.Koordinatori për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore; 1.6.Përfaqësuesi i sindikates në cilësinë e vëzhguesit; 1.7.Përfaqësues nga Këshilli i pacientëve. 2.Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat sa edhe kontrata e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur: 2.1.Anëtari ndërpre në marrëdhënien e punës në QKMF; 2.2.Anëtari i Këshillit Drejtues jep dorëheqje; 2.3.Anëtari i Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit, brenda vitit, tri herë radhazi;	Article 11 Board of Directors, Structure 1.The Board of Directors consists of 7 members: 1.1. Director of MFMC, who chairs the Board; 1.2.Head of Family Medicine Department; 1.3.MFMC Head Nurse; 1.4.Head of Administration Department; 1.5.Coordinator for improving the quality of health services; 1.6.Trade Union representative in the capacity of the observer; 1.7.Representatives from the Patient Council. 2.The mandate of the members of the Board of Directors shall last throughout the term of their employment contract, but may end even earlier in cases when: 2.1.The member terminates his employment relationship with the MFMC; 2.2.The member of the Board of Directors resigns; 2.3.The member of the Board of Directors is absent without justification from the	Član 11 Upravni savet, struktura 1.Upravni savet ima 7 članova: 1.1.Direktor GCPM-a, koji upravlja Savetom; 1.2.Rukovodilac Odeljenja porodične medicine; 1.3.Glavna medicinska sestra GCPM-a; 1.4.Rukovodilac Odeljenja administracije; 1.5.Koordinator za povećanje kvaliteta zdravstvenih usluga; 1.6.Predstavnik administracije u svojstvu posmatrača; 1.7. Predstavnici saveta pacijenata. 2.Mandat članova Upravnog saveta traje koliko i njihov radni ugovor, ali može da se završi i ranije u slučajevima kada: 2.1. Član prekida radni odnos pri GCPM-om; 2.2. Član Upravnog saveta daje ostavku; 2.3. Član Upravnog saveta bez razloga odsustvuje na sastancima Saveta. unutar

përputhshmëri me ligjin dhe me këtë Statut; 1.7.Harton planin e burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikat e MSh; 1.8.Miraton planin vjetor për ZhVP të kuadrit mjekësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij; 1.9.Bënë planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë; 1.10.Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese; 1.11.Vendos për sigurimin e pasurisë së QKMF, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit; 1.12.Propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore të MSh; 1.13.Kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetence, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF.	other acts in accordance with the law and this Statute; 1.7.Drafts the human resources plan according to the proposal of the Professional Council within the available resources and in accordance with the policies of the MoH; 1.8.Approves the annual CPD plan of medical staff and health associates and ensures its application; 1.9.Prepare the plan and program of measures for protection at work; 1.10.Appoints interim commissions and other working bodies; 1.11.Decides on the insurance of MFMC property, employees' insurance in accordance with the law; 1.12.Proposes the construction and adaptation of facilities, as well as the sources of funds for the performance of these works on the basis of the health policy of the MoH; 1.13.Performs other tasks which pertain to its competence, according to this statute and other normative acts of MFMC.	1.7.Izrađuje plan ljudskih resursa po predlogu Profesionalnog saveta unutar raspoloživih resursa i u skladu sa politikama MZ; 1.8.Izrađuje plan o KPR lekarskog osoblja i zdravstvenih saradnika i obezbeđuje njegovu primenu; 1.9.Izrađuje plan i program mera za zaštitu na radu; 1.10.Imenuje privremene komisije i ostale radne organe; 1.11.Odlučuje o osiguranju imovine GCPM-a, osiguranje radnika na osnovu zakona; 1.12.Predlaže izgradnju i adaptiranje objekata, kao i o izvorima sredstava za obavljanje ovih radova na osnovu zdravstvenih politika MZ-a; 1.13.Obavlja i druge zadatke koja su mu ostavljene u nadležnosti ovim Statutom i ostalim normativnim aktima GCPM-a.
2.Këshilli Drejtues i QKMF i kryen detyrat brenda përgjegjësiave të veta në takime.	2. The Board of Directors of MFMC carries out its duties within its responsibilities in meetings.	2. Upravni savet GCPM obavlja zadatke unutar njegovih odgovornosti na sastancima.

3. Drejtori i QKMF i përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ dhe financiar të të gjitha funksioneve të shërbimeve në QKMF, Drejtorit Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	3. The Director of MFMC is accountable for the medical, administrative and financial management of all service functions in the MFMC, to the Municipal Director of Health and Social Welfare.	3. Direktor GCPM odgovara za lekarsko, administrativno i finansijsko rukovodstvo svih funkcija usluga u GCPM, Opštinskom direktoru za zdravstvo i socijalnu zaštitu.
Neni 14 Procedura për emërimin e Drejtorit 1. Drejtorin e zgjedh Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. 2. Drejtor i QKMF duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi: 2.1. Të jetë Mjek specialist nga Mjekësia Familjare; 2.2. Përparesi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor; 2.3. Kandidati për Drejtor duhet t'i ketë 5 vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale.	Article 14 The Procedure for appointing the Director 1. The director is appointed by the Municipal Directorate for Health and Social Welfare. 2. The person to be appointed the director of MFMC should meet the general and special conditions of employment, based on the laws in force: 2.1. Should be a specialist doctor of the Family Medicine; 2.2. Candidates who have proven experience in the family medicine implementation process or candidates having professional education in the field of health management shall have an advantage; 2.3. The candidate for the position of Director must have 5 years of work experience in the public health system of which 3 years should pertain to work experience in managerial positions.	Član 14 Postupak za imenovanje direktora 1. Direktora bira Opštinska Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu. 2. Za direktora GCPM-a treba odabrati lice koje ispunjava opšte i posebne uslove zapošljavanja na osnovu zakona na snazi: 2.1. Da je lekar specijalista Porodične medicine; 2.2. Prednost će imati kandidati koji imaju dokazano iskustvo u procesu sprovođenja porodične medicine ili kandidati sa stručnim školovanjem u oblasti zdravstvenog rukovodstva; 2.3. Kandidat za direktora treba da ima 5 godina radnog iskustva u javnom zdravstvenom sistemu od kojih 3 godine radnog iskustva u rukovodećim položajima;

2.2..Drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore; 2.3.Nën mbikëqytjen dhe autorizimin e Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale zbaton buxhetin e QKMF; 2.4.Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF; 2.5.Avancon punën ekipore; 2.6.Mundëson Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF; 2.7.Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë; 2.8.Kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF.	2.2.The Director is responsible for the implementation of the Human Resources Plan; 2.3.Under the supervision and authorization of the Municipal Directorate of Health and Social Welfare implements the MFMC budget; 2.4.Is responsible for the daily management of the work process in the MFMC; 2.5.Promotes the teamwork; 2.6.Enables Continuous Professional Development and training of the MFMC staff; 2.7.Manages the implementation of quality standards; 2.8.Contributes to the development and implementation of the MFMC health information system.	2.2.Direktor je odgovoran za sprovođenje Plana ljudskih resursa; 2.3.Pod nadzorom i ovlašćenjem Opštinske Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu realizuje budžet GCPM-a; 2.4.Odgovoran je za svakodnevno upravljanje procesom rada u GCPM-u; 2.5.Unapređuje ekipni rad; 2.6.Omogućava kontinuirani profesionalni razvoj i obuku osoblja GCPM-a; 2.7.Rukovodi sprovođenje standarda kvaliteta; 2.8.Doprinosi razvoju sistema zdravstvenog informisanja GCPM-a.
3.Programi i punës së QKMF-së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të hartuara nga MSH. 4.Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF si: 4.1. Plani vjetor i punës; 4.2. Organizimi dhe udhëheqja; 4.3. Burimet njerëzore; 4.4. Plani financiar;	3.The work program of the MFMC is implemented based on the health system development policies drafted by the MoH. 4.In the annual work program must be defined the objectives, activities and expected results in the MFMC, such as: 4.1. Annual work plan; 4.2. Organization and administering; 4.3. Human Resources; 4.4. Financial Plan;	3.Program rada GCPM-a se realizuje na osnovu razvojnih politika zdravstvenog sistema izrađenih od MZ. 4.U godišnjem programu rada treba da se odredeju ciljevi, aktivnosti i očekivani rezultati u GCPM-a, kao što su: 4.1. Godišnji plan rada; 4.2. Organizovanje i upravljanje; 4.3. Ljudski resursi; 4.4. Finansijski plan;

1.1.Këshilli Profesional; 1.2.Komisioni Disiplinor i QKMF; 1.3.Komisioni i Ankesave i QKMF; 1.4.Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore; 1.5.Komisioni Etiko – Profesional. 2.Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori i QKMF. 3.Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF.	establishes Professional Bodies in MFMC, such as: 1.1.Professional Council; 1.2.MFMC Disciplinary Commission; 1.3.MFMC Complaints Commission; 1.4.Committee on Quality and Safety of Health Services; 1.5.Professional Ethics Commission. 2.The members of the professional bodies are appointed by the Director of MFMC. 3.The Board of Directors, if necessary, may establish other professional bodies in the MFMC through the Director of MFMC.	1.1.Professionalni savet; 1.2.Disciplinska komisija GCPM-a; 1.3.Komisija za žalbe GCPM-a; 1.4.Komiteet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga; 1.5.Etičko – profesionalna komisija. 2.Članove stručnih tela imenuje direktor GCPM-a. 3.Upravni savet, preko direktora GCPM-a, prema potrebi, može da formira i druga profesionalna tela u GCPM-u.
Neni 18 Këshilli Profesional 1.Këshilli Profesional është trup këshillëdhënës i Drejtorit të QKMF. 2.Këshilli Profesional përbëhet nga Udhëheqësit e Departamenteve, Udhëheqësit e Sektoreve dhe Njësitë, Shëfit të Barnatores gendrore si dhe Kryeinfiermieri/ja e QKMF, sipas nenit 9 të këtij Statuti.	Article 18 Professional Council 1.The Professional Council is an advisory body to the MFMC Director. 2.The Professional Council consists of the Heads of Departments, the Heads of Sectors and Units, the Head of the Central Pharmacy and the Head Nurse of the MFMC, in accordance with article 9 of this Statut.	Član 18 Professionalni savet 1.Professionalni savet je savetodavno telo direktora GCPM-a. 2.Professionalni savet se sastoji od rukovodioca Odeljenja, rukovodioca Sektora i Jedinica, šefa centralne Apoteke kao i glavne medicinske sestice GCPM-a, prema članu 9. ovog Statuta.

përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë; 7.3.Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale; 7.4.Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale 7.5.Kërkon raport me shkrim nga profesionistët shëndetësor për njohuritë e fituara nga ZhVP; 7.6.Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.	work and conditions for the conduction of the activity; 7.3.Proposes the structure of internal supervision, related to the work of health employees as well as measures for improving the professional performance; 7.4.Reviews the need for continuous professional development and proposes to the director the sending of health employees to professional development programs/opportunities; 7.5.Requires written reports from health professionals on the knowledge gained from the CPD; 7.6.Reviews and decides on other matters, which are submitted to the Professional Council by the director.	organizovaniya rada i uslova za razvoj delatnosti; 7.3.Predlaže strukturu unutrašnjeg nadzora, u vezi sa radom zdravstvenih radnika kao i mere za poboljšanje profesionalnog rada; 7.4.Razmatra potrebu za kontinuirani profesionalni razvoj i predlaže direktoru da se zdravstveni radnici šalju na profesionalno obučavanje; 7.5.Traži pismeni izveštaj od zdravstvenih stručnjaka o znanju stečenom od KPR-a; 7.6.Razmatra i odlučuje o ostalim pitanjima, koja direktor postavlja pred Upravnim savetom.
Neni 19 Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore 1.Në QKMF funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore. 2.Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore (në vazhdim vetëm Komiteti) është një ekip multi-disciplinar i cili përbëhet nga:	Article 19 Committee on Quality and Safety of Health Services 1. There is a Committee on Quality and Safety of Health Services which operates within the MFMC. 2. The Committee on Quality and Safety of Health Services (hereinafter referred to only as: the Committee) is a multi-disciplinary team consisting of the:	Član 19 Komitet za kvalitet i sigurnost zdravstvenih usluga; 1.U GCPM funkcioniše Komitet za obezbeđivanje kvaliteta zdravstvenih usluga. 2.Komitet kvaliteta i obezbeđivanje zdravstvenih usluga (u nastavku samo Komitet) je više-disciplinska ekipa koja se sastoji od:

Neni 22 Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional	Article 22 Continuous Professional Development	Član 22 Kontinuirani profesionalni razvoj
1. Institucionet shëndetësore në KPSH janë të obliguara që të mundësojnë dhe përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë. 2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë në KPSH, dhe zbatohet sipas planprogramit, të aprovuar nga Odat e Professionistëve Shëndetësorë. 3. Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2 i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe caktohen sipas Termave të Referencës të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë. 4. Financimi i ZHVP të profesionistët shëndetësor bëhet nga buxheti i QKMF-së dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.	1. Health institutions in the PHC are obliged to enable and support the continuous professional development of their health employees. 2. Continuous professional development is mandatory for all health professionals in the PHC, and is implemented according to the curriculum, approved by the Chambers of Health Professionals. 3. Persons responsible for conducting the activities, from paragraph 2 of this article are the Coordinators and trainers in the Family Medicine and Family Nursing Programs, who must have adequate academic and professional training and are appointed pursuant to the Terms of Reference drafted by the Ministry of Health. 4. The financing of CPD of health professionals is carried out using the MFMC budget and other sources based on normative acts in force.	1. Zdravstvene ustanove u ISZ-u su dužne da omoguće i podrže kontinuiran stručni razvoj njihovih zdravstvenih radnika. 2. Kontinuirani stručni razvoj je obavezan za sve zdravstvene stručnjake u ISZ-u, i primenjuje se prema planu i programu usvojenom od Komore zdravstvenih stručnjaka. 3. Za razvoj aktivnosti, iz stava 2 ovog člana 31, odgovorni su koordinatori i treneri u Programima porodične medicine i porodične nege, koji treba da imaju adekvatno akademsko i profesionalno zvanje i koji se određuju po opisu zadatka izrađenom od Ministarstvu zdravlja. 4. Finansiranje KPR-a zdravstvenih stručnjaka se obavlja iz budžeta GCPM-a i ostalih izvora na osnovu normativnih akata na snazi.

VII- Aktet nga veprimtaria e Institucionit	VII- Institution activity acts	VII- Akti za delatnost institucije
Neni 24 Aktet e përgjithshme 1.Me propozim të Drejtorit, Këshilli Drejtues i QKMF nxjerr këto akte të përgjithshme: 1.1.Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës; 1.2.Rregulloren për punë; 1.3.Rregulloren për mbrojtjen në punë; 1.4.Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit; 1.5.Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm; 1.6.Rregulloren për rendin shtëpiak; 1.7.Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme; 1.8.Rregulloren për parandalimin e infeksioneve; 1.9.Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF.	Article 24 General acts 1.At the proposal of the Director, the MFMC Board of Directors issues the following general acts: 1.1.Regulation on internal organization and systematization of job positions; 1.2.Rules of procedure; 1.3.Regulation on protection at work; 1.4.Fire Protection Regulation; 1.5.Regulation on internal accounting; 1.6.Regulation on house rules; 1.7.Regulation on internal supervision; 1.8.Regulation on prevention of infections; 1.9.Other regulations on the progress of work in the MFMC.	Član 24 Opšti akti 1.Na predlog direktora, Upravni savet GCPM-a usvaja ove opšte akte: 1.1.Pravilnik o unutrašnjem organizovanju i sistematizaciji radnih mesta; 1.2.Pravilnik o zaštiti na radu; 1.3.Pravilnik o zaštiti na radu; 1.4.Pravilnik o zaštiti protiv požara; 1.5.Pravilnik o unutrašnjem računovodstvu; 1.6.Pravilnik o kućnom redu; 1.7.Pravilnik o unutrašnjem nadzoru; 1.8.Pravilnik o sprečavanju infekcija; 1.9.Ostale Pravilnike o radu u GCPM-a.

3.Prokurimi i QKMF bëhet në pajtim me rregullat e Prokurimit Publik sipas Ligjit në fuqi dhe akteve nën-ligjore. 4.Drejtori mund të kërkojë auditim të jashtëm dhe të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.	3.Procurement in the MFMC is carried out in accordance with the rules of Public Procurement pursuant to the Law in force and sub-legal acts. 4.The director may request an external audit and monitor the proper use of the funds.	3.Nabavka u GCPM se obavlja u skladu sa pravilima Javne nabavke prema Zakonu na snazi i podzakonskim aktima. 4.Direktor može da zahteva spoljnu reviziju i da posmatra pravilno korišćenje sredstava.
Neni 27 Financiimi 1.QKMF shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Kosovës, Buxheti i Komunave dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse. 2.Procedura dhe forma e bashkëpagesës për shërbimet e ofruara në QKMF përcaktohet me akt nënligjor bazuar në Ligjin për Shëndetësi.	Article 27 Financing 1.In accordance with the Law on Health of Kosovo, the Law on Local Self-Government, the MFMC uses the financial resources from the Kosovo Budget, Budget of Municipalities and other sources, as provided for by relevant laws. 2.The procedure and form of co-payment for the services provided at the MFMC is determined by a sub-legal act based on the Law on Health.	Član 27 Finansiranje 1.GCPM koristi finansijske izvore u skladu sa Zakonom o zdravstvu Kosova, Zakonom o lokalnoj samoupravi, iz budžeta Kosova, budžeta opština i iz ostalih izvora predviđenih dotičnim zakonima. 2.Procedura i oblik participacije za usluge pružene u GCPM-u se određuju podzakonskim aktom na osnovu Zakona o zdravstvu.
Neni 28 Shtojca Aneksi 1 është pjesë përbërëse e këtij Statuti.	Article 28 Annex 1 Annex 1 is an integral part of the present Statute.	Član 28 Dodatak Dodatak1 je sastavni deo ovog Statuta.



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 2-155/40304
Nje. Cng. 2
Nr. ifaq. 7
Data 15/11/2022



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

DATË/A:	15.11.2022
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj.Leonora Shehu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite Shqyrtimin dhe miratimin e Model-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut.



Të nderuar,

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, kërkon nga ju shqyrtimin dhe miratimin e Model-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut.

Të bashkëngjitur në kërkesë keni edhe raportin e Grupit Punues për plotësim-ndryshimin e kësaj rregulloreje.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK



2-155/10287
2
15 11 2022

DATE/A:	08.11.2022
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi-Kryesues i Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	znj.Leonora She hu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Raporti i grupit punues per plotësim-ndryshimin e Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut.



Grupi punes ka qenë i ngarkuar për hartimin dhe plotësim -ndryshimin e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Junikut.

Grupi punues i formuar nga Kryetari i Komunës me vendim të datës 10 tetor 2022, ka mbajtur disa takime, dhe kemi arritur në përfundim se duhet të bëhet harmonizimi i Rregullores me Udhëzimin Administrativ nr.02/2019-të MAPL-së.

Grupi punues ka konstatuar, se duhet të bëhen plotësim -ndryshime të këto nene të kësaj Rregullore, duke u bazuar tek Udhëzimi Administrativ nr.02/2019.

Duhet të bëhet plotësim-ndryshimi i:

1.PREAMBULËS SË RREGULLORES:

Nga

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2 pika c, në bazë të nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ të MAPL nr. 2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, të nenit 15 të Statutit të Komunës së Junikut, nr. 001/3127, të dt. 30.09.2010, vendimit të dt. 27.03.2015, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e vet, të mbajtur më _____ miraton:

Në

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Nenit 13-15, të Statutit të Komunës së Junikut, 001/3127, të dt. 30.09.2010, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e mbajtur më dt. 00.00.2022, miratoi këtë.

NDYSHOHEN -PLOTESOHEN NENET E KËSAJ RREGULLORJE SI NË VIJIM:

Neni 3

Hiqet

Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

Ky nen plotësohet me tabelen -Nr.1. të cilën e përpilon Komisioni i zgjedhur nga Kuvendi Komunal prej 5-7 antarëve.

1. Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019, neni 4, paragrafi 2, pika 2.3, në bazë të numrit të banorëve caktohet edhe numri i Këshillave lokale.

Neni 4

Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

Ndryshohet

Nga:

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 5-7 anëtarë: 4 anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një anëtar nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Përbërja e komisionit duhet të

përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.

2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
3. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
 - 4.1.shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale;
 - 4.2.mediave lokale;
 - 4.3.web – faqes zyrtare të komunës.
5. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë:
 - 5.1 rendin e ditës;
 - 5.2 datën;
 - 5.3 kohën;
 - 5.4 vendin e mbajtjes së tubimit.
6. Pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale, komisionet e formuara nga Kuvendet e Komunës pushojnë aktivitetin e tyre.

Në

Neni 4

1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtar, katër (4) nga Kuvendi i Komunës, një (1) nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ndërsa përfaqësuesi (1) nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, zgjedhet në mënyrë ad-hoc nga Komisioni. Komisioni duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik.Nga shtatë (7) anëtarët e komisionit tre (3) duhet të jenë femra.

2. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit. Mandati i komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

5. Së paku katër (4) anëtar të Komisionit të Kuvendit të Komunës, duhet të jenë të pranishëm në të gjitha takimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.

6. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.

7. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin e përzgjedhjes së këshillave lokale.

8. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:

8.1. shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale;

8.2. mediave lokale;

8.3. web – faqes zyrtare të komunës.

9. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë: rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së tubimit.

Neni 4 t'i shtohet neni 4A, lidhur me Komisionin për ankesa:

1. Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e ankesave, i cili i shqyrtojn ankesat lidhur me procesin e zgjedhjeve të këshillave lokale.

2. Komisioni i ankesave do të përbëhet prej tre anëtarëve që zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numër më tëmadh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.

3. Të gjithë pjesëmarrësit në takimin zgjedhor mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë procesit zgjedhor.

4. Ankesat për shkelje apo parregullsi në procesin zgjedhor duhet të paraqiten pranë Komisionit për ankesa, brenda 3 (tri) ditëve të punës.

5. Komisioni i ankesave është i obliguar që ti shqyrtoj të gjitha ankesat dhe brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimi të kërkesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre personave që kanë parashtruar ankesë. Vendimet e Komisionit të ankesave i përcjellen Kryesuesit të Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale menjëherë pas marrjes së tyre.

6. Vendimet e Komisionit të ankesave janë obligative.

7. Komisioni i ankesave i raportyon Kuvendit të Komunës.

Ndryshohet

Neni 5

Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes

Nga

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë prej 5 deri në 7 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Përbërja e këshillave lokale të fshatit duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30%. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal.
3. Tubimet e qytetarëve i udhëheq një përfaqësues i fshatit i zgjedhur nga shumica e pjesëmarrësve në tubimin zgjedhor, apo anetari me i moshuar pjesemarrës në atë tubim.

4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal, me rastin e tubimit të qytetarëve, që mbledh të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Zgjedhja mund të bëhet përmes votimit të hapur apo votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve. Votimi i fshehtë mund të propozohet nga çdo qytetar që merr pjesë në takim nëse përkrahet nga 1/3 e pjesëmarësve që marrin pjesë në tubim.
6. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë qytetarë të përhershëm në atë lokalitet.
7. Kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillit lokal, duhet të kandidohen si qytetarë e jo në emër të ndonjë partie politike.
8. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
9. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim. Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e votave atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për kryetar të këshillit lokal.
10. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjedhen me mandat 3 vjeçar.
11. Së paku tre anëtar të komisionit të komunës duhet të jenë prezent në të gjitha tubimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokale.

Në

1. Këshilli lokal mund të ketë nga pesë (5) deri në nëntë (9) anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Çdo fshat, vendbanim apo lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në rast kur këshilli lokal ka numër çift të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, atëherë fshtai, vendbanimi ose lagjja urbane me numër më të madh të banorëve përfaqësohet me dy anëtar në këshillin lokal.
3. Përbërja e këshillave lokale të fshatit duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30%. Në rast se në

fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal.

4. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve.
5. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale duhet të jenë qytetarë të përhershëm në atë lokalitet.
6. Kandidatët për anëtarë apo kryetarëve të këshillit lokal, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur apo emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve politike.
7. Anëtar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.
8. Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.
9. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë mbahet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për anëtar dhe kryetar të këshillit lokal.
10. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç të atij lokaliteti. Çdo fshat, vendbanim apo lagje duhet të propozojë së paku dy kandidatë për përfaqësim në këshillin lokal.
11. Takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 20 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, duke respektuar kuotën gjinore. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vite.
12. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vite.

Neni.12
Financimi i aktiviteteve
Ndyshohet

Nga:

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga

donatorët, në pajtueshmëri të plotë me statutin, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.

2. Këshilli lokal bën raporte gjashtë mujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuara, si dhe atyre të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti si dhe para organeve komunale.

Në:

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes komunës dhe këshillave lokale mund të financohen si vijon:
 - 1.1 Nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
 - 1.2 Nga komuna;
 - 1.3 Nga donatorët; dhe
 - 1.4 Me financim të përbashkët.

Neni.13.

Ndeshohet

Kompenzimi i këshillave lokale

Nga:

Kompenzimi i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë.

Në:

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompenzohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
2. Kompenzimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e komiteteve obligative.
3. Kompenzimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni.15.

Ndeshohet

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

Nga:

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e komunës mbizotrojnë dispozitat e ligjit dhe statutit.

Në:

1. Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregullore me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane apo me Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit, Udhëzimit Administrativ dhe Statutit.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokale të Komunës së Junikut, të datës 30.09.2010.

Neni.16.

Ndryshohet

Nga:

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

Në:Dispozitat përfundimtare

1.Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje janë Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Administratë.

2.Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

Neni.17.

Ndryshohet

Hyrja në fuqi

Nga:

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, shqyrtimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës dhe tetë ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e komunës.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, komuna është e obliguar që brenda afatit gjashtë mujor të filloj me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Në:


Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në web-faqen e Komunës.

Datë: 08.11.2022


Haxhë Krasniqi – Kryesues



Sundim Krasniqi – Anëtar



Gëzim Geci - Anëtar





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr.
DATË:	21.11.2022
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	z.Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

Bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040); me Ligjin Nr.06/L-092, neni 13, pika 1 dhe 2, Publikimi i listës së pronës së paluajtshme të Komunës dhe rregulloren e Kuvendit të Komunës së Junikut, iu parashtrojmë këtë:

KËRKESË

Që të miratoni në Kuvendin e Komunës së Junikut listës së përgjithshme dhe listës së veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen për dhënie në shfrytëzim. Kërkesës i bashkangjesim listën e përgjithshme dhe listën e veçantë të paluajtshmërisë së pronës Komunale.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	2-155/10455
Një. Org	2
Nr. i faq.	6
Data	21/11/2022

Lista e veçantë e pronave Komunale që planifikohen të ipen në shfrytëzim

Nr.	Certifikata nr.	Ngastr a	Titullari	Sipërfaqja - m ²	Kultura-Klasa	Vendi i quajtur
1	116	704	Komuna Junik	56579	Mal-4	Vreshtat- Rogopeq
2	//	793	//	17089	Kullosë-4	Bajraktar-Rogopeq
3	//	804	//	51249	Mal-4	Vreshta -Rogopeq
	//	5032	//	13817	Mal - 3	Qesta e Qokut
	//	5035	//	69770	Mal-2	//
4	//	1174	//	7633	Jo pjellore	Bajraktar- Varrezat e Imeraj
5	//	5183		1080	Tokë ndërtimore- Oborr	Hoxhë
6	//	3973	//	13072	Kullosë-3	Kloshe -Qesta e Gojanit
7	//	3975	//	1527	Mal-3	//
8	//	4042	//	1099	Livadh-3	Lluga e Begut-Bramatok
9	//	4064	//	618	Kullosë-2	//
	115	1036-1	Pasuri shoqërore – Bashkësia lokale Junik	8616	Kullosë -3	Pepsh- Vreshta e Pepshit
	//	1036-2		548	Rrugë	//

Lista e përgjithëshme e pronave Komunale – Komuna Junik

Nr.	Certifikata nr.	Ngaztra	Titullari	Sipërfaqja - m ²	Kultura	Vendi i quajtur
1	116	139	Komuna Junik	1047	Jopjellore	Brija-Qafa e Jasigjit
2	//	141		3679	Jopjellore	//
3	//	553		926	Varreza	Piskavica-Gurthi
4	//	554		5775	Varreza	//
5	//	565		2003	Varreza	//
6	//	579		64 199 2320	Shtëpi Varreza Kulloshë-4	Seishta – Tyrtja e Dervish
7	//	704	//	56579	Mal-4	Vreshtat-Rogopeq
8	//	770	//	1029	Jopjellore	Bajraktar – Ligata
9	//	776	//	310	Kulloshë-2	Bajraktar
10	//	778	//	998	Varreza	Bajraktar
11	//	793	//	17089	Kulloshë-4	Bajraktar-Rogopeq
12	//	804	//	51249	Mal-4	Vreshta -Rogopeq
13	//	837	//	7660	Kulloshë-4	//
14	//	887	//	1245	Greninë	Rogopeq-Lugje
15	//	968	//	3675	Kulloshë-4	Livadhi i verrave-Q.Jasisit
16	//	969	//	2343	Mal-4	//
17	//	1046	//	4162	Varreza	Varrezat e Pepshtit
18	//	1050	//	311	Varreza	//
19	//	1052	//	4747	Varreza	//

20	//	1095	//	2058	Varreza	Varrezat e Imeraj
21	//	1174	//	7633	Jo pjellore	Bajraktar-Varrezat e Imeraj
22	//	1205	//	4810	Mal-3	Birat e dhelprave
23	//	1225	//	1153	Varreza	Bajraktar
24	//	1246	//	4733	Varreza	Bajraktar
25	//	1341	//	2341	Varreza	Hoxhë
26	//	1347	//	420	Varreza	Hoxhë
27	//	1355	//	159	Ndërtesë	Hoxhë -Trogovishtë
28	//	1356	//	180	Ndërtesë	//
29	//	1549	//	603	Varreza	Pepsh-Varrezat e Gacafërit
30	//	1563	//	25711	Varreza	//
31	//	1564	//	2468	Kullosë-3	//
32	//	1575	//	30413	Varreza	Varrezat e Gacafërit
33	//	1866	//	1131	Kullosë-4	Proni i Arashës
34	//	1867	//	7125	Jopjellore	//
35	//	1868	//	3342	Kullosë-4	//
36	//	1962	//	18111	Kullosë-3	Moronica
37	//	2018	//	1147	Maden rërë	Hoxhë-Furrat e Gjotës
38	//	5183		1080	Tokë ndërtimore- Obor	Hoxhë
40	//	2219	//	1229	Varreza	Varrezat e Qokut
41	//	2220	//	1486	Varreza	//
42	//	2311	//	24 5947	Tyrbe Varreza	Varrezat e Berishës
43	//	2439	//	3056	Mal-3	Moronica-Vneshia
44	//	2444	//	869	Mal-3	//

45	//	2449	//	15849	Mal-4	//
46	//	2542	//	170	Kullosë-3	Goqaj-Qesta
47	//	2748	//	722	Greminë	Grykae Halilit
48	//	2776	//	251	Greminë	//
49	//	2857	//	3316	Varreza	Goqaj-Varrezat e Qestaj
50	//	2860	//	312	Varreza	J//

51	//	2867	//	1548	Varreza	//
52	//	3047	//	888	Varreza	Hoxhë-varezat e Berishës
53	//	3059	//	4042	Varreza	Hoxhë-Varrezat e Qokut
54	//	3060	//	969	Varreza	//
55	//	3213	//	15057	Varreza	Piskavica-Gurthi
56	//	3214	//	972	Varreza	//
57	//	3422	//	2044	Kullosë-2	Piskavica-ledina e Mirocit
58	//	3800	//	1421	Varreza	Luge-varrezat e Qokut
59	//	3973	//	13072	Kullosë-3	Kloshe-Qesta e Gojanit
60	//	3975	//	1527	Mal-3	//
61	//	3983	//	1019	Maden-Ranë	Traval-Qesta e Gojanit
62	//	3984	//	23835	Mal-3	//
63	//	4042	//	1099	Livadh-3	Lluga e Begut-Bramatok
64	//	4064	//	618	Kullosë-2	//
65	//	4328	//	84	Shëpi	Qesta e Qokut
				6628	Kullosë-3	
66	//	4330	//	6336	Kullosë-3	//
67	//	4977	//	649	Kullosë-2	Kallavaj-Qejza
68	//	5032	//	13817	Mal-3	Qesta e Qokut
69	//	5035	//	69770	Mal-2	//
70	115	87	Pasuri Shogërore	3774	Mal-4	Zhvina-Firza
71	//	88	Bashkësia Lokale Junik	2612	Mal-4	//

72	//	92	//	1467	Mal-4	//
73	//	95	//	1761	Mal-4	//
74	//	96	//	1921	Mal-4	//
75	//	204	//	3044	Kullosë-5	Brija
76	//	235	//	32226	Mal-4	//
77	//	1036	//	9164	Kullosë-3	Pepsh-Vnesh

78	//	1352	//	16	Shtëpi Obor	Hoxhë
79	//	1357/1	//	120 500 2950	Ndërtesë Obor Kullosë-2	Hipxhë-Tregovisht
80	//	1357/2	//	550	Ndërtesë	//
81	88	1437	Pasuri Shogërore – Shkolla Filllore “Edmond Hoxha “	9019 1344	Shkolla Obor	Hoxhë
82	//	1438	//	3009	Pemishite-2	//
83	//	1453	//	135	Kullosë-2	//
84	90	1292	Pasuri Shogërore BVI për Kulturë Shtëpia e Kulturës	963 1953	Shtëpi Kullosë-2	Bajraktar- Hoxhë
85	89	1293	Pasuri Shogërore Shtëpia e Shëndetit Degan	352 1245 500	Shtëpi Kullosë-2 Obor	//